

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të:**AC-I-23-0392*****Paditësi/Parashtruesi i Revizionit*****H P, Klinë.*****Kundër******E paditura*****N.SH. "Boksitet e Kosovës", (në likuidim), Klinë, me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Djellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-21-0218-A0001, të datës 18 maj 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Revizioni i paditësit i paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-21-0218-A0001, të datës 18 maj 2023, hedhet poshtë si i pa pranueshëm.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore sipas revizionit.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 17 dhjetor 2008, paditësi kishte parashtruar një padi për kompensimin e të ardhurave personale në shumën prej 4,500.00 euro kundër N.SH "Boksitet e

Kosovës”, Klinë. Në padi theksohet se paditësi me të paditurën me datën 1 mars 2005 kishin lidhur një marrëveshje për përfaqësim në kohë të pacaktuar i të paditurës, sipas të cilës marrëveshje e paditura kishte për obligim t’i paguaj paditësit të ardhurat mujore në shumën prej 100.00 euro duke filluar nga muaji 1 mars 2005. Paditësi thekson se kishte marrë vetëm një të ardhur personale nga e paditura, dhe atë të muajit mars 2005, ndërsa nga 1 prill 2005 deri më 1 dhjetor 2008 nuk i janë paguar të ardhurat, duke llogaritur në muaj $45 \times 100 = 4,500.00$. Tutje, kishte shtuar se ai vazhdimisht ka kërkuar nga e paditura të ardhurat e papaguara, por e paditura ka arsyetuar se nuk ka mjete financiare, të cilat sapo t’i siguroj do ta përmbushë obligimin sipas marrëveshjes, të cilin deri më sot nuk e ka përmbushur.

Padisë i kishte bashkëngjitur: marrëveshjen ndërmjet paditësit dhe të paditurës të datës 1 mars 2005 të nënshkruar nga dy palët si dhe Njoftimin e datës 1 dhjetor 2008 për kompensimin e të ardhurave personale.

Me datë 17 janar 2011, paditësi kishte paraqitur një Njoftim përmes së cilit njofton gjykatën se i njëjti ka kryer shërbime juridike siç është: hartimi i padive, përfaqësimi në gjykatë, hartimi i ankesave, kërkesa të ndryshme për nevoja të së paditurës sipas marrëveshjes. Tutje, thekson se për shërbimet e bëra deri në kohën e paraqitjes së padisë ka marrë vetëm 230.00 euro. Si provë kishte bashkëngjitur: Aktvendimin mbi ndërprerjen e marrëveshjes të datës 3 maj 2010 me nr. 58, në të cilën theksohet se ndërprerja e marrëveshjes bëhet nga data 22 mars 2008.

Me datë 13 korrik 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtje në padi në të cilën thekson se e kundërshton në tërësi padinë dhe pretendimet paditore të paditësit si të pabazuara në ligj. Gjithashtu, konsideron se paditësi në padinë e tij nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën e mbështetë kërkesëpadinë, se padia nuk përmban elementet thelbësore të cilat duhet t’i përmbaj dhe sidomos argumentet ligjore në të cilat mbështetet kërkesëpadia. Për më tepër thekson se padia është e parashtruar në kundërshtim me nenin 7 të LPK-së, ku barra e të provuarit bie mbi paditësit, e paditësi në këtë rast ka dështuar të provoj të drejtën e pretenduar. Andaj kishte propozuar që të hedhet poshtë padia e paditësit si e papranueshme

ose të refuzohet si e pabazuar dhe të detyrohet paditësi t'i paguaj shpenzimet procedurale.

Me datë 16 mars 2021, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin SCC-08-0303 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar padinë e paditësit, duke obliguar AKP-në që si administruese e N.SH "Boksitet e Kosovës", në emër të përfaqësimit të kësaj të fundit nga paditësi, t'i kompensoj të njëjtit të ardhurat personale në shumën prej 3,470.00 euro me interes ligjor për mjetet e depozituara në bankë mbi një vit, pa destinim të caktuar dhe atë duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 17 dhjetor 2008 deri më 19 dhjetor 2012, ndërsa pas kësaj date 8% të interesit vjetor deri në përmbushjen e plotë. Gjithashtu, e kishte refuzuar si të pabazuar shumën prej 1,030.00 euro në emër të kompensimit për të ardhurat personale si dhe kishte obliguar ankuesin të paguaj taksën gjyqësore prej 25 euro, ndërsa e paditura t'i bartë shpenzimet gjyqësore. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi thuhet se duke e kalkuluar periudhën nga 1 mars 2005 kur ishte lidhur marrëveshja deri më 22 mars 2008 kur ishte ndërprerë, shihet që paditësi ka ofruar shërbime për N.SH-në 36 muaj e 3 javë dhe shuma që i takon për kompensim është 3,700.00. Mirëpo, për shkak se paditësi në parashtresën e datës 17 janar 2011 ka pohuar se ka pranuar një pagesë në shumën prej 230.00 euro, rezulton se i ka borxh vetëm 3,470.00 euro. Pretendimi i paditësit se ka punuar deri më 1 dhjetor 2008 mbetet i pabazuar për shkak se nga Aktvendimi i datës 22 mars 2008, N.SH-ja kishte ndërprerë marrëveshjen e datës 1 mars 2005, prandaj i njëjti nuk gëzon të drejtën e kompensimit pas ndërprerjes së marrëveshjes dhe për këtë arsye pjesa tjetër në shumën prej 1,030.00 euro refuzohet si e pabazuar. Sa i përket mbrojtjes së të paditurës, gjykata thekson se është kryesisht e përgjithësuar dhe nuk është e mbështetur në asnjë argument bindës që do të ndryshonte vendosjen e kësaj çështje juridike, pasi që paditësi me padi dhe prova tjera të lartpërmendura kishte provuar arsyeshëm padinë e tij.

Me datë 1 prill 2021, AKP (e paditura) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit SCC-08-0303 të datës 16 mars 2021, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar

Kolegjit të Apelit që të aprovohet ankesa e N.SH "Boksitet e Kosovës" dhe të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim, me ç' rast të udhëzohet trupi gjykues të pezulloj procedurën ose të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet në tërësi si e pabazuar padia e paditësit H P. Në ankesën e të paditurës theksohet se AL me datën 3 shkurt 2021 e ka njoftuar DHPGJS-në që ndërmarrja në fjalë ka hyrë në likuidim dhe në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në ka kërkuar që DHPGJS-ja të ndërpres/pezulloj çdo procedurë gjyqësore që ka të bëjë me ndërmarrjen shoqërore "Boksitet e Kosovës". Prandaj, gjykata me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit të ankimuar ka shkelur dispozitat e nenit 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, ashtu që në vend që të pezulloj procedurën lidhur me këtë lëndë, gjykata vendos që të procedoj dhe të nxjerr Aktgjykimin e ankimuar. Gjithashtu konsideron se gjykata ka vendosur për këtë çështje pa mbajtur fare seancë gjyqësore ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 23 pika 1 e Ligjit 06/L-086 për DHPGJS-në dhe nenit 182.2 nënpika h) e Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sa i përket konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e paditura konsideron se DHPGJS me anë të aktgjykimit ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike kur ka konstatuar se paditësi ka ofruar shërbime për N.SH-në për 36 muaj e 3 javë, për faktin se paditësi as përmes padisë së tij as duke u përgjigjur në urdhër nuk ka arritur të argumentoj as vetëm një shërbim juridik për dhe në emër të ndërmarrjes shoqërore "Boksitet e Kosovës". Si rezultat i shkeljeve procedurale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga ana e gjykatës është zbatuar gabimisht edhe e drejta materiale në kuptim të nenit 184 të LPK-së. Ankesës i kishte bashkëngjitur provat si në vijim: Aktgjykimin e ankimuar, vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së nr. REF. BD-144/8 të datës 22 dhjetor 2020, Njoftimin e datës 3 shkurt 2021 drejtuar DHPGJS-së, Udhëzimin C-IV-15-1607 të datës 15 tetor 2015, Aktvendimin AC-I-15-0260 të datës 22 dhjetor 2015, Komentarin e LPK-së lidhur me nenin 398, Aktgjykimi C-III-13-0499 i datës 22 nëntor 2017, Aktgjykimi AC-I-17-0689 i datës 24 qershor 2020 dhe Njoftimin e paditësit të datës 17 janar 2011 drejtuar DHPGJS-së.

Me datë 26 shtator 2022, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, në të cilën thekson se gjykata ka marrë Aktgjykim meritore rreth kësaj

çështje juridiko civile duke u bazuar në provat materiale të nënshkruar nga të dy palët procedurale, prandaj i kishte propozuar Kolegjit të Apelit ta hedhë ankesën e të paditurës si të pabazë dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Me datë 18 maj 2023, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-21-0218-A0001, ankesën e të paditurës e aprovon si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe e pezullon procedurën lidhur me padinë e paditësit të datës 17 dhjetor 2008. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se me datë 17 dhjetor 2008, paditësi kishte parashtruar një padi për kompensimin e të ardhurave personale në shumën prej 4,500.00 euro kundër N.SH "Boksitet e Kosovës", Klinë. Ndërsa, me datë 16 mars 2021, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin SCC-08-0303 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar padinë e paditësit, duke obliguar AKP-në që si administruese e N.SH "Boksitet e Kosovës", t'i kompensoj paditësit të ardhurat personale në shumën prej 3,470.00 euro me kamatë për mjetet e depozituara në bankë mbi një vit, pa destinim të caktuar. AKM-ja me Vendimin e Bordit të datës 22 dhjetor 2020 kishte iniciuar procedurën e likuidimit të N.SH "Boksitet e Kosovës", që do të hynte në fuqi me datë 18 janar 2021. Ndërsa Aktgjykimi i shkallës së parë i DHPGJS-së ishte nxjerr me datës 16 mars 2021 afërsisht 02 muaj pas fillimit të procedurës së likuidimit. Me datë 3 shkurt 2021 AKP-ja përmes një njoftimi drejtuar DHPGJS-së, kishte njoftuar të njëjtën që *"Në përputhje me nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, kërkojmë ndërprerjen e të gjitha çështjeve kundër ndërmarrjes së lartpërmendur (Boksitet e Kosovës) të cilat aktualisht janë (ose mund të jenë në të ardhmen) në gjykatë"*. Sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së dhe dispozitave ligjore në fuqi, likuidimi vullnetar i një ndërmarrje automatikisht shpie në ndalimin e çfarëdo procedure gjyqësore në kohën kur iniciohet procedura e likuidimit për të siguruar trajtim të barabartë të kreditorëve të cilët nuk mund të lejohen të kërkojnë interesat e tyre individuale pavarësisht kreditorëve tjerë brenda procedurës së rregullt civile. Në këtë rast, kreditorët duhet të parashtrojnë kërkesat e tyre sipas nenit 69 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut 200/8/6 gjegjësisht nenit 35 të Shtojcës së Ligjit mbi AKP-në, tek Autoriteti i Likuidimit i cili pastaj e krijon listën përfundimtare të kërkesave në pajtim me prioritetet e përcaktuara me ligj. Padia fillestare ishte një padi kreditorë kundër N.SH-së ndaj

së cilës filloi procedura e likuidimit pasi që paditësi kërkoi kompensim monetar për shërbimet e kryera për të paditurën . Shkalla e parë pas marrjes së Njoftimit nga AKP-ja duhet të kishte pezulluar procedurën për arsyet e cekura me lart.

Me datë 19 qershor 2023, paditësi përmes postës e dërgon në DHPGJS një revizion të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, AC-I-21-0218-A0001, të datës 18 maj 2023, për Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Paditësi në revizion ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës të aprovohet revizioni si i bazuar, të anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Apelit , AC-I-21-0218-A0001, i datës 18 maj 2023, dhe çështja lidhur me padinë të kthehet në rishqyrtim tek Gjykata e Shkallës së I-rë. Për më tepër në revizion paditësi ka pohuar se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin SCC-08-0303, të datës 16 mars 2021, e ka aprovuar pjesërisht padinë e paditësit, duke obliguar të paditurën të paguajë shumën në emër të pagave të pa paguara prej 3,470.00 euro, me kamatë ligjore. Tutje në revizion paditësi pohon se Kolegji i Apelit me Aktvendimin e tij AC-I-21-0218-A0001, të datës 18 maj 2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës, e ka anuluar Aktgjykimin e ankimuar dhe e ka pezulluar procedurën lidhur me padinë. Në revizion paditësi pretendon se Kolegji i Apelit me Aktvendimin e tij ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, duke pezulluar procedurën lidhur me padinë. Tutje paditësi pohon se padia e tij është paraqitur në Gjykatë me datë 05.12.2008, ndërsa njoftimi për likuidim të NSH-së është marrë me datë 03.02.2021. Nga njoftimi për likuidim e deri më sot AKP-ja nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për likuidimin e NSH "Boksitet e Kosovës", edhe pse kanë kaluar mbi dy vite. Tutje në këtë revizion paditësi pretendon se Gjykata ka shkelur nenin 160 paragrafi 4 lidhur me nenin 182 paragrafi 2 të LPK-së, pasi që Gjykata nuk ka dhënë fakte vendimtare pse e ka pezulluar këtë procedurë. Ai pretendon se Gjykata nuk e ka arsyetuar faktin pse nuk e ka vazhduar procedurën sipas nenit 10 par.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësi pretendon se me lejen e Gjykatës kjo procedurë mund të vazhdojë dhe arsyeja për të vazhduar procedura është se kjo9 procedurë ka filluar që 15 vite, ndërsa njoftimi për likuidim është vetëm arsye që kjo lëndë të shtyhet pafundësisht. Tutje ai pohon se kërkesën për kompensim të pagave e ka dorëzuar në AKP edhe me datën

03.03.2021, pas marrjes së vendimit për likuidim. Padiësi po ashtu pretendon se Shkalla e I-rë në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe po ashtu në mënyrë të drejtë e ka zbatuar edhe të drejtën materiale kur ajo e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e padiësit. Në revizion padiësi pohon se me datë 01 mars 2005 ai dhe e paditura ishin marrë vesh që e paditura në çdo muaj të paguajë shumë prej 100 euro, padiësit i cili është avokat, ndërsa padiësi ka marrë obligim që me këtë marrëveshje të kryejë punët juridike për të paditurën, si përfaqësimi i të paditurës në seanca, përpilimi i shkresave, etj. Padiësi pohon se kjo marrëveshje ka zgjatur deri me datë 01.12.2008, mirëpo e paditura nuk e ka paguar borxhin përveçse një shumë të vogël e cila ceket në vendimin e Shkallës së I-rë.

Me datë 23 gusht 2023, AKP-ja e ka dorëzuar një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në revizionin e padiësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet e padiësit të paraqitura në revizion dhe e mbështet në tërësi Aktvendimin e Kolegjit të Apelit me të cilën është pezulluar procedura lidhur me padinë, pasi që NSH "Boksitet e Kosovës", është në likuidim. AKP-ja në këtë parashtresë ka kërkuar që të hedhet poshtë revizioni i padiësit, pasi që aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të formës së prerë dhe ndaj tyre nuk ka mundësi ankesë të mëtejme. AKP-ja konsideron se Revizioni është mjet i palejueshëm ndaj vendimeve të DHPGJS-së, sipas LDHP-së. AKP-ja pohon se DHPGJS-ja ka dhënë qëndrimet e saja juridike në rastet identike, dhe i referohet disa rasteve nga jurisprudenca e DHPGJS-së.

Arsyetimi ligjor

Revizioni i parashtruar nga padiësi është i papranueshëm.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Kolegji i Apelit nuk e procedoj revizionin me dosje në Gjykatën Supreme të Kosovës, siç ka kërkuar paditësi në revizion, pasi që në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme lidhur me objektin e kontestit të padisë së paditësit është përcaktuar kompetenca ekskluzive e DHPGJS-së që të vendosë për konteste të tilla.

Kolegji i Apelit vlerëson se në bazë të nenit 9 paragrafi 14 i Ligjit Nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër. LDHP-ja nuk parasheh mjetin e jashtëzakonshëm juridik kundër aktgjykimeve ose Aktvendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS (me Rregullore të UNMIK-ut 2008/4 dhe as me Urdhëresën Administrative 2008/6 nuk parashihet asnjë mjetë i jashtëzakonshëm juridik).

Neni 9 paragrafët 14 dhe 15 të LDHP-së përjashtojnë zbatueshmërinë e dispozitave të Ligjit për Procedurë Kontestimore sa i përket mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

Edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës duke vendosur lidhur me vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të DHPGJS-së,ASC-11-0056-A0001,të datës 7 qershor 2012, në rastin Nr.KI 103/12,në pikën e 23 të Aktvendimit për papranueshmërinë, të marrë me datë 22 mars 2013, duke argumentuar pikën lidhur me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës të parashtruar para asaj gjykate, në këtë vendim shpreh opinionin e vet ligjor se ***"23.Në këtë drejtim, Gjykata vëren se ,në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj."*** I ngjashëm është opinionin e Gjykatës kushtetuese edhe në rastin e saj nr.KI 57/13 datë 15 korrik 2013,pika 20 e Aktvendimit për papranueshmëri i nxjerr lidhur me ankesën kushtetuese ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së,ASC-11-0035 datë 23 nëntor 2012,dhe në rastin KI23/14 datë 3 mars 2014,pika e 31 të Aktvendimit për papranueshmëri, i nxjerr lidhur me ankesën kushtetuese ndaj Aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së,ASC-09-0084 dhe ASC-09-0101.

Edhe më i drejtpërdrejtë është qëndrimi ligjor i Gjykatës Kushtetuese në rastin e saj nr. KI 02/15 me të cilin me Aktvendimin për papranueshmëri është hedhur poshtë kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të DHPGJS-së: AC-I-14-0077, AC-I-14-0078, AC-I-14-0079 dhe AC-I-14-0080, të datës 15 shtator 2014. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka marrë qëndrimin vijues ligjor **„29. Është tërësisht e qartë se vendimet e DHPGJS-së nuk mund të jenë objekt i asnjë lloj procedure të mëtutjeshme qoftë edhe gjyqësore, përveç objekt i trajtimit në Gjykatën Kushtetuese...“**, ndërsa në pikën 34 të të njëjtit rast shprehet qëndrimi vijues ligjor **“34. Duke marrë parasysh faktin se sipas nenit 1 të Ligjit për DHPGJS-në ajo është pjesë e Gjykatës Supreme, duke marrë për bazë edhe specifikat e saj të veçanta në funksionimin e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe procedurat të cilat zhvillohen në këtë institucion gjyqësor, Gjykata nuk gjen se me Aktvendimet me të cilat janë hedhur poshtë revizioni dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, DUDNJ dhe KEDNJ.”**

Edhe ky opinion ligjor i Gjykatës Kushtetuese të dhënë në këto raste, e vërteton saktësinë e interpretimit ligjor që i bënë Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, nenit 9.14 të LDHP-së.

Palët, përveç në Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 9.15 të LDHP-së, nuk kanë në dispozicion siç u cek më lartë as një mjet tjetër juridik, përfshirë edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike, për ti atakuar vendimet e formës së prerë të Kolegjit të Apelit. Kjo vlen edhe për Prokurorin e Shtetit i cili në interesin e mbrojtjes së ligjshmërisë me iniciativën e palës apo ex officio vepron dhe është i autorizuar me ligj të paraqesë Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj një vendimi të formës së prerë, por jo edhe ndaj një vendimi të tillë të marrë në shkallën e dytë për brenda Gjykatës Supreme apo ndaj një vendimi të tillë të marrë në shkallën e dytë për brenda Dhomës së posaçme si pjesë e saj.

Dispozitat e LDHP-së si ligj special kanë përparësi aplikimi ndaj LPK-së si ligj procedural i përgjithshëm.

Dispozita e nenit 76 paragrafi 3 e LDHP-së e parasheh mundësin e aplikimit të dispozitave të LPK-së në procedurat para DHPGJS-së, **“...kudo që është e nevojshme për ta zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë**

ligj...”, mirëpo çështja nëse mundet më tej të goditet vendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (rasti siç u tha më sipër është vetëm në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, në bazë të nenit 9.15 të LDHP-së), është e rregulluar shumë qartë.

Mjetet e jashtëzakonshme juridike, Revizioni sipas nenit 211.1 Përsëritja e procedurës të përfunduar me vendim të formës së prerë sipas nenit 232 dhe Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas 245.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore Nr.03/L-006, asnjëra nga ato mjete, siç u cekë më lartë nuk janë të zbatueshme, nëse ato paraqiten nga kush do qoftë, ndaj në vendimi të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, pasi që ato në bazë të nenit 9.14 të LDHP-së janë vendime të formës së prerë, pa mundësi ankimimi të mëtejme.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në bazë të nenit 1.3 të LDHP-së dhe nenit 21 të ligjit mbi gjykatat, është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës, do të thotë nuk është gjykatë e një instance gjyqësore më e ulët nga Gjykata Supreme, siç janë Gjykatat Themelore dhe Gjykata e Apelit, por ajo në aspektin e hierarkisë, është në vijë dhe rangë me Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila në bazë të nenit 21.1 të Ligjit mbi Gjykatat është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë.

Andaj vendimet e formës së prerë të Kolegjit të Apelit si instancë e dytë gjyqësore e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në bazë të asnjë dispozite procedurale të LPK-së, nuk ka mundësi të rishqyrtohen nga asnjë kolegji tjetër i Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që vendimi i formës së prerë i marrë në shkallën e dytë nga Dhoma e Posaçme si pjesë e Gjykatës Supreme, është përfundimtar dhe nuk ka më në bazë të ligjit, ndonjë autoritet më të lartë gjyqësor të rregullt të bëjë shqyrtimin e mëtejme të tij.

Andaj vendimi i formës së prerë i një kolegji të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme apo dhe ai i Kolegjit të Shkallës së Dytë të Dhomës së Posaçme si pjesë e saj, për kah mundësia e ankimimit të mëtejme të tyre, janë qartazi të dallueshme nga çdo vendim tjetër i formës së prerë të marrë nga ndonjë gjykatë e rregullt tjetër në Kosovë, të instancës më të ulët gjyqësore.

Është e qartë se edhe LPK-ja nuk ka dhënë mundësin e goditjes të çdo vendimi të formës së prerë, e sidomos jo të atyre të marrura në shkallën e dytë të Gjykatën Supreme dhe jo edhe të atyre të marrura në shkallën e dytë të Dhomës së Posaçme, si pjesë e saj me rang hierarkik të njëjtë, por vetëm të atyre që janë marrë nga gjykatat e instancës më të ulët gjyqësore.

Kolegji i Apelit vëren se në lëndën konkrete, AC-I-21-0218-A0001 tashmë është vendosur nga Kolegji i Apelit me Aktvendimin e datës 18 maj 2023, i cili është i plotfuqishëm. Andaj, revizioni i paditësit i parashtruar kundër Aktvendimit të plotfuqishëm të Kolegjit të Apelit, si është vendosur tani me nga jurisprudenca e tij(ASC-09-0106,ASC-11-0063,ASC-11-0107,AC-I-12-0145), duhet të hedhet poshtë si i pa pranueshëm.

Për këto arsye, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi/Parashtruesi i revizionit tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën sipas revizionit në shumë prej 100 euro, me datë ---- 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
